

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“ ADA FASHION ” SH.P.K

**KAPITULLI I
EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

Neni 1: Themelimi

1. Emri i shoqërisë është **“Ada Fashion” Sh.p.k.**, këtu e më poshtë quajtur **“Shoqëria”**. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin Shqiptar nga ortaku:
Z. Salvatore Trazza Shtetas Italian, lindur më 25.12.1965 në Lecce, banues në Itali, i pajisur me pasaport Nr.YB6932204
2. Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe Statutin.

Neni 2: Objekti i Veprimtarisë

1. Objekti i shoqërisë është si më poshtë vijon:

Prodhim dhe tregtim të veshjeve dhe cdo produkti në sektorin e tekstileve. Krijimi dhe menaxhimi i cdo lloj shërbimesh publike në fushën e menaxhimit të kohës së lirë, gjatë sezonit të turizmit dhe spektaklit, duke përfshirë edhe vend pushimet, plazhe, kalatave ankorim, hotele, restorante, piceri dhomë bankete, bare, klube, sportive, biznese agriturismi, shitje-blerjen e pasurive të patundshme, ndërtim i punimeve civile dhe industriale, sisteme hidraulike, instalime, ndërtim rrugesh, etj., të marrë pjesë në gara publike dhe private, ndërtim dhe restaurim i objekteve të të gjitha llojeve, për vete dhe të tretë, shit-blerje, qeramarrje të tokës dhe ndërtesave të çdo lloji, ndërtim stendash panairesh, organizim panairesh, administrim dhe menaxhimin e të gjitha llojeve të pasurive të patundshme dhe aktivitete të tjera lidhur me ndërtimin e veprave industriale këtu përfshirë edhe fuqinë punëtore nëse kërkohet. Krijimin dhe menaxhimin e programeve kompjuterike, të menaxhimit të arkives fizike, kompjuterike, përpunimit të të dhënave, ruajtje të arkives fizike apo ne burime te tjera, blerje shitjen, instalimin dhe mbështetjen e produkteve hardware dhe software, blerjen, shitjen dhe instalimin e pajisjeve dhe mobilje zyre, duke përfshire furnizimet per vete dhe të tretë, organizimi, zbatimi dhe menaxhimi i eventeve, konventa, konferenca, kurse dhe shkolla të formimit profesional, studime dhe kerkime, sherbime formimi për sisteme informatike, zhvillimi, prodhimi dhe shpërndarja e materialeve arsimore, broshura, materiale audiovizuale, gazetave. Krijimi i qendrave të kualifikuar për qëllime statutore, promovimi, krijimi dhe pjesëmarrja në nismat promovuese të rëndësishme lokale, kombetare ose të huaj (përfshire edhe përmes hapjes së zyrave ose agjencive). Tregtim dhe prodhimi i materialeve për paketim. Për të arritur objektin e kompanise, shoqëria mund të kryej të gjitha operacionet për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe cdo veprimtari tjetër të nevojshime ose të dobishme, apo te kreditimit dhe dhenies me qira, të një pjese të shoqerisë qëllimi i të cilit është e ngjashme ose i njëjtë, përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi, për të arritur qëllimet e sipërpërmendura.

Përvec aktiviteteve kryesore, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër favorizues, ndihmës, aksesor, lehtësues, përfitues, aksidental dhe okazional, i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimtarisë së Shoqërisë.

Neni 3: Selia

Selia e shoqëria ndodhet në Rr. Spiro Çipi, Ish magazinat NPA-së, Kapanoni 2 katesh zone kadastrale 8120, Nr. pasurie 6/70", Tiranë.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve nëpërmjet një vendimi me shumicë të thjeshtë mund të ndryshojë selinë e shoqërisë, hapë ose mbyll, përkohësisht ose të përhershme, degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin.

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe të pakufizuar. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosi për zgjidhjen e parakohshme të shoqërisë.

KAPITULLI II KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT-PJESËT E KAPITALIT

Neni 5: Kapitali Themeltar dhe Ortakët

1. Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë është 100 000.(njëqind mijë) Lekë
2. Ortaku themelues i shoqërisë Z. Salvatore Trazza zotëron 1 (një) kuotë që përbën 100% (një qind për qind) të të gjithë vlerës së kapitalit themeltar.
3. Përgjegjësia e ortakut shtrihet deri në shumën e kontributit në kapitalin themeltar.

Neni 6: Transferimi i Kuotave

Pjesët e kapitalit janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve.

Të gjitha pjesët e kapitalit të Shoqërisë mund t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmonë me vendim të cilësuar të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

Kuotat janë lirisht të transferueshme.

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së shoqërisë, ortaku nuk do të lërë peng kuotat e tij respektive dhe as nuk do ti përdori si mjete garancie sipas legjilacionit Shqiptar për të garantuar detyrimet e tij personale apo detyrimet e ndonjë pale të tretë pa marrë pëlqimin nga Asambleja së përgjithshme e ortakut.



KAPITULLI III

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 7: Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë, vendimet e të cilit merren në përputhje me legjilacionin në fuqi dhe dispozitat e Statutit.

Asambleja e përgjithshme mblidhet sa herë që konsiderohet e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë, por në çdo rast, të paktën një herë në vit dhe brenda 6 mujorit të parë nga përfundimi i vitit financiar.

Asambleja e përgjithshme ka këto kompetenca:

- përcaktimin e politikave tregtare dhe ekonomike të shoqërisë si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga administratori;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ret si dhe shpërblimin e tyre;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesit/ve dhe të ekspertit/ëve kontabël të autorizuar si dhe shpërblimin e tyre;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e buxhetit vjetor;
- përfaqësimin e shoqërisë në proceset gjyqësore;
- Ndryshimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
- Shpërdarja e fitimeve ose dividendëve;
- Ristrukturimin e shoqërisë ose prishjen e saj;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- Çdo çështje tjetër të parashikuara nga ky Statut dhe ligjislacioni në fuqi.

Neni 8: Thirrja, përfaqësimi dhe proces-verbalet e mbledhjes

Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% (për qind) të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.

Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% (për qind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratorët mund të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe këtë gjë duhet ta bëjnë të paktën një herë në vit. Gjithashtu, thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë që një gjë e tillë është në interes apo e nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të: a) një letre që dërgohet me postë rekomandë ose b) me komunikim me postë elektronike, që i drejtohet ortakut. Njoftimi për mbledhje duhet dërguar të paktën 7 ditë përpara datës së mbledhjes.

Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:



- a) Emrin e shoqërisë, zyrën qendrore, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
- b) Rendin e ditës

Konfirmimi postar për marrjen në dorëzim të njoftimit (letres) ose komunikimi me postë elektronike për të marrë pjesë në Asambleshën e Përgjithshme do të bashkangjitet procesverbalit të Asmbledhjes. Konfirmimi nuk është i nevojshëm nëse ortaku ose përfaqësuesi rregullisht i autorizuar është prezent në mbledhje.

Ortaku mund të përfaqësohet në asambleshën e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asambleshën e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e mara, qëndrimin e kryetarit për vendimarrjen, si dhe të ortakëve, që janë shprehur kundër.

Neni 9: Administratori


Administrator i shoqërisë mund të jetë edhe një person që nuk është ortak i shoqërisë. Administratori, administron dhe drejton aktivitetin e Shoqërisë si dhe përfaqëson ligjërisht shoqërinë kundrejt të tremeve. Ai është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e përditshëm të Shoqërisë, për përmbushjen e të gjitha detyrave të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Administrator i shoqërisë ushtron kompetencat sipas ligjit dhe këtij statuti për një periudhe 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Emërimi i Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit të tij në QKB. Ky pozicion do të mbahet nga:

Znj. Brunilda Serani Shtetas Shqiptar, lindur më 23.02.1981 në Permet, banues në Përmet, e pajisur me letënjoftimin Nr pasaporte BC 3910840 dhe Nr personal I15223073G.

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet, duke patur parasysh kufizimet sipas këtij Statuti dhe/ose aplikimit të ligjit në fuqi:

- a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor si dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin Asamblesë së Përgjithshme për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve
- e) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- f) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare apo të ligjeve të tjera;
- g) të raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;



h) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori emëron dhe shkarkon personelin e shoqërisë. Shpërblimi i personelit bëhet nga Administratori, sipas kriterëve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori mund të emëroje një përfaqësues “ad negotia” për ushtrimin e detyrave apo kategorive të detyrave të veçanta, brenda kufijve të kompetencave të dhëna.

Shoqëria, nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme, nënshkruan me administratorin një marrëdhënie pune ose shërbimi, ku specifikon detajet ose përshkrimin specifik të natyrës së shërbimeve që administratori siguron në favor të shoqërisë.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, FITIMET DHE HUMBJET, FONDET REZERVË

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 12: Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë, ku si fillim është data e regjistrimit të shoqërisë.

Neni 13 – Fitimet dhe humbjet

Llogaritë vjetore, inventarët, raportët mbi operacionet e vitit financiar dhe raportët e veçanta të hartuara nga administratorët, apo nga ekspertët kontabel miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Miratimi i dokumentëve financiare vjetorë bëhet brenda një afati 3-mujor, të mbylljes së vitit financiar.

Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme, vendos rreth shpërndarjes së dividendeve, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, si parashikohet nga ligji.

Neni 14: Rezerva

Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë krijimin e rezervave nga fitimet vjetore. Shoqëria llogarit e ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumat e caktuara për rezervat e përmendura si më lart.

Neni 15: Deklarimi i dividendit

Dividendi është pjesa që i takon ortakut nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme. Fitimet vjetore llogariten në përputhje me parimet e përcaktuara nga ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe çdo lloj ligji të aplikueshëm në këtë kuptim.

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon ndryshe, dividendi shpërndahet mes ortakëve, në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Neni 16: Prishja dhe likuidimi



Përveç rasteve të parashikuara nga ligji, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, me një vendim të cilesuar, mund të vendosë prishjen e parakohshme të Shoqërisë dhe venien e saj nën likuidim.

Për këtë qëllim, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të përcaktojë procedurat dhe mënyrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar ato ç'ka janë parashikimet e ligjit.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme emeron një a me tepër likuidues, duke përcaktuar për secilin kompetencat dhe funksionet në kryerjen e procedurave të likuidimit.

KAPITULLI V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 17: Ligji i zbatueshëm

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit në Shqipëri në lidhje me shoqëritë tragtare.

Neni 18: Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje, konflikt ose pretendim që është parashikuar ose jo me këtë Statut, çdo shkelje ose pavlefshmëri, do të zgjidhet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky statut mund të shtohet, ndryshohet ose të zëvendësohet me një Statut të ri vetëm me vendim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

Ky statut është përpiluar dhe firmosur në 4 (katër) kopje me fuqi të barabartë juridike.

Nënshkruar sot, Tiranë, më 29.04. 2021

ORTAKU

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Salvatore Trazza

